

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2118/11 Prot.

Durrës, më 18.09.2025

VENDIM

Nr. 100, datë 18.09.2025

PËR

"DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" ZNJ. LEA YPI"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", kreu V, neni 1; të shkresës Nr. 1864 Prot., datë 05.08.2025 të Rektorit "Mbi dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa", për Znj. Lea Ypi", si dhe të shkresës së MAS Nr. 1864/1 prot, datë 20.08.2025, në mbledhjen e datës 18.09.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit "Doctor Honoris Causa" Znj. Lea Ypi nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, me motivacion:
"Në vlerësim të kontributeve të saj të shquara në teorinë politike dhe mendimin botëror; angazhimit të saj të thellë në çështjet e lirisë; drejtësisë dhe ideologjisë; rolit të saj të jashtëzakonshëm në lidhjen e mendimit shkencor me diskursin publik; ndikimin e saj ndërkombëtarisht në hulumtimin e themeleve morale të mendimit politik; rigorozitetin e saj kërkimor-shkencor; thellësinë e analizës dhe përkushtimin në qëndrueshmërinë e shpirtit njerëzor; arritjet kolosale letrare dhe intelektuale; fuqinë transformuese të ideve të saj dhe frymëzimit të atyre ideve të përcjella te brezat e shumë kombeve; zërin e fortë në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve dhe për promovimin në mbarë botën e përmes dhjetra gjuhëve të historisë dhe vlerave të Shqipërisë".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtoria e Projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

